

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18, dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 14 dhe neni 29 paragrafin (2) të Ligjit për Media ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë") nr.184/13, 13/14, 63/24, 74/24 dhe 218/24), Udhëzimi për përmbushjen e detyrimeve për impresium dhe informacion në dispozicion të përdoruesve, ark.nr.01-4443/1 datë 09.10.2018, pikat 7 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për marrjen e masave (Tekst i pastruar) ark. nr. 01-4139/1, datë 07.11.2022, Raporti me shkrim për Mbikëqyrjen Administrative të kryer ark.nr. 01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-1350/1 datë 27.03.2025 dhe Konkluzionin nr.02-1670/3 datë 10.04.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 16-të mbajtur më 10.04.2025 miratoi si vijon:

Aktvendim për ndërmarrjen e masës – paralajmërim publik

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) KLAN MAQEDONI SHPKNJП eksport-import Saraj, Shkup, për shkelje të nenit 14 të Ligjit për Media (LM), në atë mënyrë që transmetuesi në kuadër të shërbimit programor televiziv të transmetuar më 4 mars 2025, nuk ka publikuar impresium në emisioneve edukative me përmbajtje fetare: "Merr Frymë" (Dishi) dhe "N'konak te Hoxha" (Vo konakot na Oxhata) dhe emisionit aktual-informativ "Klan debat".

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.10-1350/1 datë 27.03.2025, që është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET që SHTR КЛАН МАЉЕДОНИ СХПКНЈП экспорт-импорт Сарај, Схкуп, në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi, ta harmonizojë punën e saj me dispozitat e LM.

3. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe data e miratimit të tij llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia, në bazë të nenit 29 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) dhe neni 29 të Ligjit për Media (LM), është kompetente për të kryer mbikëqyrje administrative të veprimtarisë së botuesve të mediave nga aspekti i pajtueshmërisë së veprimtarisë së tyre me detyrimet e përcaktuara në nenet 6, 8, 14 dhe 15 të LM.

Në përputhje me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndaj botuesi të medias (transmetuesit) ndërmerr masë - paralajmërim publik në rastet kur është kryer shkelje ose shkelje e dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe akte tjetra të Agjencisë.

Në përputhje me nenin 29 paragrafi (2) të LM, masat që Agjencia si organ rregullator kompetent, mund t'i ndërmarrë janë të përcaktuara në LSHMAAV dhe zbatohen gjithashtu edhe në rast të shkeljes së dispozitave të LM.

Sipas nenit 14 të Ligjit për Media, botuesi i medias është i detyruar në vend të dukshëm për çdo bartës të përmbajtjes (për shembull, kopje të medias së shtypur dhe emisioni televiziv) të sigurojë publikimin e të dhënave në vijim: emrin dhe adresën e selisë dhe redaksinë e botuesit të

medias, emrin e personit përgjegjës të botuesit të medias, emrin dhe mbiemrin redaktorit përgjegjës, përkatësisht redaktorëve në përputhje me organizimin e brendshëm të redaksisë, emrin dhe adresën e shtypshkronjës dhe datën e shtypjes ose ribotimit, si dhe numrin e kopjeve të shtypura, kur bëhet fjalë për media të shtypur. Për transmetuesit, detyrimi i mësipërm zbatohet në atë mënyrë që të dhënat publikohen në fillim ose në fund të programeve audio/audiovizuale. Botuesi i medias është i detyruar në vendin e përshtatshëm për çdo përmbajtje të publikojë të dhënat në vijim: emrin dhe mbiemrin e autorit të shtojcës së publikuar, emrin dhe mbiemrin e personit, gjegjësisht të shoqërisë që ka të drejtën e autorit për përmbajtjen e publikuar, përveç në mediat e shkruara dhe programet në radio, datën e produksionit (muajin dhe vitin) kur bëhet fjalë për vepra audio/audiovizuale dhe nëse vepra është krijuar nga produksion i pavarur dhe informacion për të njëjtin, emri i personit juridik, përkatësisht emri dhe mbiemri i personit që ruan pasurinë kulturore ose veprën arkivore të përdorur, përkatësisht reproduksionin përkatës dhe emrin e botuesit të medias nga i cili është marrë produksioni programor ose fragmenti nga produksioni programor, përveç nëse me marrëveshje të përbashkët parashihet ndryshe.

Në përputhje me pikën 6 të Udhëzimit për përmbushjen e detyrimeve për impresium dhe informacionin në dispozicion të përdoruesve, ark.nr.01-4443/1 datë 09.10.2018, për programet e tjera të prodhimit vendas, impresium publikohet në atë mënyrë që: në shpikën hyrëse ose mbylljes të publikohen të dhënat e mëposhtme: emri dhe mbiemri i redaktorit përgjegjës të shërbimit programor; emrin dhe mbiemrin i redaktorit përgjegjës të redaksisë nga ku buron programi (nëse ka); emri dhe mbiemri i redaktorit/autorit/ drejtuesit të emisionit; emrin dhe mbiemrin e bashkautorëve, pra të gjithë ekipit televiziv me pjesëmarrje në tërësinë e veprës audiovizive; emrin e subjektit që ka prodhuar programin (vetë transmetuesi, bashkëproducentët, producenti i pavarur të cilit i është porositur programi) dhe datën e produksionit (muajin dhe vitin). Nëse është e mundur, duhet të publikohen dhe të dhënat për: emrin e personit juridik, përkatësisht emrin dhe mbiemrin e personit që ruan pasurinë kulturore të përdorur ose veprën arkivore, pra riprodhimin e veprës, dhe emrin e një subjekti tjetër nga i cili është marrë fragment i caktuar ose pjesë e fragmentit, përveç nëse parashihet ndryshe me marrëveshje të përbashkët.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia përmes Sektorit për çështje programore, më 27 mars 2025, ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative (monitorim) të shërbimit programor televiziv të SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj, Shkup, transmetuar më 4 mars 2025. Nga ku është konstatuar shkelje të nenit 14 nga LM. Nga mbikëqyrja është konstatuar se në kundërshtim me LM dhe Udhëzimin për përmbushjen e detyrimeve për impresium dhe informacion në dispozicion të përdoruesve, pa impresium janë transmetuar: emisioni aktual-informativ "Klan debat" dhe emisionet edukative me përmbajtje fetare me rastin e Ramazanit: "Merr Frymë" ("Dishi") dhe "Në konak te Hoxha"(Vo konakot na Oxhata". Përkatësisht, në vend të përshtatshëm, për çdo përmbajtje të shërbimit programor, transmetuesi është i detyruar ligjërisht të transmetojë të dhënat që identifikojnë autorët që kanë marrë pjesë në përgatitjen e përmbajtjes programore: *emrin dhe mbiemrin e kryeredaktorit të shërbimit programor; emrin dhe mbiemrin e kryeredaktorit të redaksisë nga e ka origjinën programi; emri dhe mbiemri i redaktorit/autorit/ drejtuesit të emisionit; emri dhe mbiemri i bashkautorëve, pra i gjithë grupit televiziv me pjesëmarrje në tërësinë e veprës audiovizive; emri i subjektit që ka prodhuar programin; data e produksionit.*

Shkeljen e pikës 1 të këtij aktvendimi, është specifikuar sipas datës, titullit të emisionit, periudhës së transmetimit (fillimit dhe përfundimit) dhe përshkrimit në Raportin me shkrim mbi mbikëqyrjen administrative, ark.nr.10-1350/1, datë 27.03.2025, që është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj, Shkup, më 28.03.2025, dërgoi Shkresë nr ynë.ark.10-1350/2 datë 28.03.2025, me të cilin ka dorëzuar Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, ark. nr.10-1350/1 datë 27.03.2025, që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të shkeresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LM. Shkresa është pranuar në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 01.04.2025. Këshilli i Agjencisë, në seancën e 16-të mbajtur më 10.04.2025, shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe konstatoi që SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj, Shkup, t'i shqiptohet masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 14 dhe nenin 29 paragrafin (2) të LM, Udhëzimit për përmbushjen e detyrimeve për impresium dhe informacionet e disponueshme për përdoruesit,

pika 7 dhe 14 të udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar), Raporti me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative ark.nr.10-1350/1 datë 27.03.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-1670/3 datë 10.04.2025, për konstatim të mos respektimit të dispozitave të LM, përcaktuara në pikën 1 të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 16- të mbajtur më 10.04.2025, ka miratuar Aktvendim ku publikisht paralajmërohet SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj, Shkup dhe e urdhëron që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimi të këtij Aktvendimi, ta harmonizojë punën e saj me dispozitat e LM. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, Agjencia të kryejë mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrur, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në përputhje me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

Bazuar nga sa më sipër u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.10-1350/1 datë 27.03.2025 .

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.